



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 61, datë 10.09.2025

PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË PIKËN NR. 2 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 66, DATË 25.06.2024 “PËR PËRCAKTIMIN E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË PARKIMIT ME PAGESË NË RRUGË DHE SHESHE NË TERRITORIN E BASHKISË Durrës”

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 89/2022, datë 22.12.2022 “Për policinë bashkiake”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 7, datë 10.06.2008 “Mbi rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit, që do të kryejë administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.194, datë 22.12.2023 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2024”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 66, datë 25.06.2024 “Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe në territorin e bashkisë Durrës”, shkresës nr.10322, prot., datë 01.09.2025 nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, shkresës nr.10322/1 prot., datë 02.09.2025 nga Drejtoria Ligjore si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:



1. Miratimin e një shtese në pikën nr. 2 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 66, datë 25.06.2024 “Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit

të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe në territorin e bashkisë Durrës”, duke shtuar pas nënpikës 7, nënpikën 8 me emërtimin:

8. Sheshi “26 Nëntori 1912”, pranë Stacionit të Trenit, Durrës

2. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 11.09.2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 600/prot.
8

Durrës, më 12 09.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

BASHKIA DURRE
15-09-25 Nr. 8213/8

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.61 datë 10.09.2025 ,” Për miratimin e një shtese në pikën nr. 2 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 66, datë 25.06.2024 “Për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe në territorin e Bashkisë Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

